

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarës A. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 par.1 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.917/2013 të datës 18.06.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarës, me date 17.01.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### E akuzuara:

**A. K.**, nga i ati F. dhe nëna R. e lindur B., e lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton, në rrugën ..., nr..., ka të kryer shkollën e mesme të mjekësisë, motër medicinale, e shkurore, nënë e një fëmijë, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R E

Se me datën 11.03.2013, në kohën të pacaktuar, në Prizren, në rrugën.... , nr..., pikërisht në barnatoren "A.", pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave – produkteve medicinale (barërave) pa banderola, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli rutinor nga NJHKEK, inspektorët e ATK-ës, farmaceutike, sanitarë dhe krim-teknika rajonale nuk ka poseduar dokumentacion përkatës dhe ka pasur gjashtë kuti të ndryshme të barërave pa banderola,

- këso dore ka kryer veprën penale tregti e ndaluar nga neni 305 par.1 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, të akuzuarit ia shqipton:

## DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet e akuzuara që të paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.917/2013 të datës 18.06.2013, të akuzuarës A. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Sahide Sefa në fjalën e saj përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr. 917/2013 të datës 18.06.2013, të parashtruar ndaj të pandehurës A. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 par.1 të KP-së., e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës, e cila në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që e njëjta të shpallet fajtoresh dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

E akuzuara A. K., në fjalën e saj përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën e ngritur ndaj meje, që nga fillimi i këtij shqyrtimi, kam tentuar në çdo mënyrë të tregoj dhe të vërtetoj gjykatës pafajësinë time, dhe ate me anë të provave të ndryshme, që unë kam qenë punëtore në barnatoren e cekur, por edhe për kundër administrimit të gjitha provave të deritashme gjatë shqyrtimit gjyqësor, kam vërejt që nuk ka mundësi ligjore për shmangie nga përgjegjësia penale gjegjësisht të vërtetohet e kundërta e asaj të përshkruar në dispozitiv. E udhëzuar nga ana e gjykatës që pranimi i fajësisë është një rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, sot në shqyrtimin gjyqësor e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, rrethanat e mia personale, që jam person familjar, nënë e një fëmiut, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më e kujdesshme dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 11.03.2013, në kohën të pacaktuar, në Prizren, në rrugën ..., nr..., pikërisht në barnatoren "A.", e akuzuara pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave – produkteve medicinave (barërave) pa banderola, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli rutinor nga NJHKEK, inspektorët e ATK-ës, farmaceutike, sanitarë dhe krim-teknika rajonale nuk ka poseduar dokumentacion përkatës dhe ka pasur gjashtë kuti të ndryshme të barërave pa banderola,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës, e cila në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat e akuzuara ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim

me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarën e shpalli fajtores dhe i shqiptoi dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e saj penale juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtës, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarës në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e saj pas konfliktit, është nënë e një fëmijë, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë e dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.976/2013 me datë 17.01.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.